REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

**KOMUNA E GJAKOVËS**

OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove
01 Nr./Br. 011/01-3525
Data/Datum 10. 02. 2022
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

**Kuvendi i Komunës - Gjakovë**
**01 Nr. ______________/2022**
**Dt.07.02.2022**

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 21 paragrafi 1.3 të Ligjit nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, në mbledhjen e mbajtur me dt.07.02.2022, pas diskutimeve lidhur më pikën e 12-të të rendit të ditës: Kërkesa e DUMM-së për Shfrytëzimin – Servitutin në pronën Publike me karakter Rrugë Publike Lokale, për Zhvendosjen dhe Zgjerimin e rrjetit elektro energjetik të tensionit të mesëm, e miratoi këtë:

## Vendim

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për lejimin e shfrytëzimit dhe krijimin e servitutit në pronën komunale në brezat e rrugëve Publike Lokale sipas projekteve të KEDS, me qëllim të zgjerimit dhe zhvendosjes së rrjetit ekzistues nga traseja aktuale e tensionit të Mesëm, rekonstruimin e LP (6 kërkesa për tensionin e Mesëm), dhe rekonstruimin e rrjetit të tensionit të ulët me tensionin e Mesëm ( 15 kërkesa për tensionin e Ulët dhe të Mesëm) së bashku me stabilimentet ekzistuese por edhe ngritjen e stabilimenteve të reja .

2. Lejohet Shfrytëzimi dhe krijimin e servitutit në pronën komunale në brezat e rrugëve Publike Lokale sipas listës për "rekostruim (Zhvendosjen e LP, zgjerim i rrjetit të LP-së të TM dhe rekonstruim i Tu-së) .
   - Meje1(Lapidari)..........................................................................351/03-10856
   - Dallashaj-Dobroshi......................................................................351/03-10859
   - Janosh..........................................................................................351/03-10866
   - Shoshi Skivjan ( deri tek ferma e Pulave )....................................351/03-10861
   - Madaj 2 .......................................................................................351/03-13979
   - Kusari 1 ( me Pjetershan) ...........................................................351/03-13977
   - Janosh NEW TR1 .........................................................................351/03-13973
   - Janosh NEW TR2 .........................................................................351/03-18562

Lista për "Rekonstruimin (zhvendosjen e linjës )dhe zgjerimin e larg përçueseve 10/20kv-Tensioni i Mesëm".

- LP Bishtazhini ..............................................................................351/03-10871
  (përfshin fshatrat Raçë, Pjetërshan, Smaç, Rogovë, Kushavec, Bishtazhin, Lipovec dhe Gërçinë ).
- LP Ura e Terezive ...........................................................................351/03-10872
  (Përfshin fshatrat:Smaq, Ujz, Rogova I dhe IIdhe pjesërisht, Marmull, Damjan, dhe bordosanë).
- LP Ponoshec.......... .........................................................................351/03-10869
  (Përfshin fshatrat: Devë , Duzhnje, Babaj Bokës, Popoc, Ponashec dhëmborinë).
- LP Dobrosh ......................................................................................351/03-13972

(Përfshin fshatrat: Meje, Rracaj, Sheremet, Dobrosh, Molliq, Brovinë, dhe Botushë).

- LP Linja 1 .....................................................................................351/03-13968
  (Përfshin fshatrat: Skivjan, Planqor, Dujakë, Hereç, Osek Pashë, Trakaniq, Novosellë dhe Firajë).
- LP Linja 2 .....................................................................................351/03-13966
  (Përfshin fshatrat: Palabardh Sopot, Zhdredh, Meqe, Cermjan, gërgoc, Zhabel dhe Kralan).

**3.** Lidhur me kohëzgjatjen e të drejtës së servitutit, e njëjta do të rregullohet sipas dispozitave Ligjore që rregullojnë këtë të drejtë.

**4.** Autorizohen organet e administratës komunale që të ndjekin procedurat ligjore për zbatimin e këtij vendimi sipas shënimeve të cekur në pikën e 1dhe 2 të këtij vendimi.

**5.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës .

**6.** Vendimi iu dërgohet:
- Z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës.
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit .
- Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
- Arkivit,

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

________________________

Znj. Arbënesha Kuqi